UNLOCK HEALTH CARE IN NYC

NYC CARE Member Handbook

English page 1
Shqip faqe 17

NYC HEALTH+ HOSPITALS | NYC CARE

NYC HEALTH+ HOSPITALS | NYC CARE

Our Fellow New Yorker:

In our city, we recognize health care is a human right. Now, we are putting our values into practice. Thanks to NYC Care and the hardworking professionals at NYC Health + Hospitals, every New Yorker – regardless of where they were born or how much money they have – is guaranteed the right to quality, affordable health care. That includes YOU.

With NYC Care, you will have your own regular doctor who you know and receive your health care from. You will get the kinds of services you need, including OB-GYN, pediatric care and mental health care. You will have the ability to stay healthy and to take care of any health issues early and effectively. And all services will be provided at a price you can afford.

This handbook describes the comprehensive benefits and services you receive as a member of NYC Care. For more information, call 1-646-NYC-CARE at any time of day or night, or visit our website at **nyccare.nyc**.

Our message is simple: Get your NYC Care card and schedule an appointment with your new doctor. Don't wait. Get the health care you need, when you need it. That's your right as a New Yorker!



Dr. Mitchell Katz
President and CEO
NYC Health + Hospitals

CONTENTS

About This Handbook 4

About NYC Care 4
How much does it cost to participate 5
How to renew your membership 5

Your Membership Card 5
How to replace your membership card 6

Your Primary Care Provider 6
How to choose your primary care provider 6

Your Health Care Services 7
Primary and Preventive Care 7
Specialty Care 7
Behavioral Health and Substance Use 7
Women's Health 8
Medications 8
Vision 8
Support Services 8
Health care services not covered 9

How To Get And Manage Your Care 9
How to make your appointments 9
About MyChart online 10
Get ready for your first appointment 10

Billing and Fees 11
How to pay 11

Policies and Procedures 11
Patients' Bill of Rights 11
Your cost to access care 12
How to submit feedback to NYC Care 14
Confidentiality of information 14

About NYC Health + Hospitals 15

NYC Health + Hospitals Mission and Values 16

ABOUT THIS HANDBOOK

This handbook is your guide to NYC Care. In it, you will find helpful information about your membership and how the program works. Please read it before going to the first appointment with your primary care provider.

ABOUT NYC CARE

NYC Care is the key to the City's health care that guarantees access to medical services offered by NYC Health + Hospitals to New Yorkers who do not qualify for health insurance or cannot afford health insurance.

NYC Care helps you stay healthy with access to regular, preventive care. Through this program, you can:

- Choose a primary care provider, who will learn about your medical history and health goals. You do not have to wait until you are sick to get care.
- Get a unique membership card to access health care. Your card shows the fees you can expect to pay for services.
- Call our NYC Care Contact Center, available 24/7, when you need help. In case of emergency, always call 911.
- Get access 24/7 to low-cost prescription medication, including off-hour pickups for regular refills. You can also get refills overnight when needed.

WHERE CAN I USE NYC CARE?

NYC Care offers a network of providers only at NYC Health + Hospitals facilities. Find a list of fees to get services at these sites on your card.

You may get a higher bill if you receive emergency care, are hospitalized or visit providers out of network or outside New York City.

For a list of NYC Health + Hospitals locations where you can use NYC Care, call the NYC Care Contact Center or visit **nyccare.nyc**

Important: People who are eligible for Medicaid, Medicare, the Essential Plan or a Qualified Health Plan (QHP) available through the Affordable Care Act (ACA) should enroll in the insurance plan available to them.

If you have health insurance now, do NOT drop it. Insurance provides more choices and options to meet your health care needs.

How much does it cost to participate

Since NYC Care is not health insurance, there are no membership fees, monthly fees or premiums. Your cost to receive health care is based on a sliding-scale fee per service (see page 12).


How to renew your membership

NYC Care will have a financial counselor at NYC Health + Hospitals screen you every 12 months. The screening will show if you are eligible for insurance. If not, the financial counselor will help you renew your NYC Care membership.

YOUR MEMBERSHIP CARD

You will get a membership card in the mail. Carry this card always but especially when:

- Visiting your primary care provider
- Getting any health care services at NYC Health + Hospitals facilities



The card shown is a sample of the front and back of an NYC Care membership card.

Your card is unique to you and shows your fees for health care services.

How to replace your membership card

If you lose your membership card, call the NYC Care Contact Center at 1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273) to order a new one. Customer Service is available 24/7.

YOUR PRIMARY CARE PROVIDER



Your primary care provider will coordinate your health care and connect you with other services you need. Your provider can be a doctor, nurse practitioner or physician assistant. Their most important job is to help you avoid getting sick. This is called preventive care (examples are routine health screenings and vaccinations). Getting it regularly makes needing emergency care less likely.

How to choose your primary care provider

For the best preventive care, NYC Care encourages you to choose a primary care provider that you can trust. This will make sharing your medical and lifestyle information easier. You will work together to begin, or continue, a health routine that includes diet, weight control and exercise.

The NYC Care Contact Center helped you choose a primary care provider when you enrolled. If you have not chosen or want to change your primary care provider, you can call the NYC Care Contact Center. It is important that you feel comfortable with your choice.

YOUR HEALTH CARE SERVICES

As a member of NYC Care, you have access to many health services. Your primary care provider will help coordinate them, including medication. All specialty services (like Cardiology or Podiatry) need a referral from your primary care provider – except Women's Health.

Some of the health care services available to you are:

Primary and Preventive Care

Your primary care provider treats routine physical conditions, such as high blood pressure and pain. They can give routine vaccinations and screenings, like mammograms and colonoscopies. They also test for and help you manage chronic disease.

Your primary care provider leads your health care team. It may include nurses, medical assistants, social workers, pharmacists, nutritionists and assistants. They can all help you ask for referrals or make appointments.

Generally, if you are healthy, you only need to visit your primary care provider once a year. (Patients with chronic disease need visits more often.)

However, you can visit your primary care provider whenever you have a health concern. For urgent services, the NYC Care Contact Center can make same-day appointments 24/7.

Specialty Care

Your primary care provider works closely with specialists and can help decide if you need their services. Examples of specialty care services are:

- Cardiology
- Rheumatology
- Orthopedics
- Podiatry
- Bariatrics
- Gastroenterology
- General Surgery
- Ear, Nose and Throat (ENT)
- Psychiatry

Behavioral Health and Substance Use

Besides your physical health, NYC Care knows that mental and behavioral health is also important. Your primary care provider is here to support you if you are going through a long period of sadness, stress, nightmares or anxiety or are using tobacco, alcohol or other drugs. Your provider can refer you to the right mental and behavioral health specialist, like a social worker, therapist or psychiatrist.

Women's Health

NYC Care members get Women's Health services like Obstetrics and Gynecology, family planning, sexually transmitted infection testing and more.

Medications

NYC Care members get low-cost prescription medication and pharmacy access 24/7. Remember to read the information on your medication to learn when and how to take it.

IMPORTANT

You do not need a referral from a primary care provider to make an appointment with a Women's Health provider.

You can get refills for some medication. There are three ways to ask for refills:

1. Go to the pharmacy at any NYC Health + Hospitals facility and ask them to call your primary care provider.
2. If you have a MyChart account, log on and ask for a refill.
3. Call the NYC Care Contact Center at 1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273).

Vision

Our ophthalmologists (eye doctors) can examine your eyes and give you eyeglass prescriptions. Get a referral from your primary care provider.

Support Services

Where and how you live may affect your physical, mental and behavioral health. NYC Care knows this, so it offers support services. The social workers in your health care team can connect you with free housing, legal, financial, food and nutrition help. Speak with your primary care provider about the social support that NYC Care offers.

Health care services not covered

NYC Care does not cover these services, but you may be able to get them at NYC Health + Hospitals:

- Cosmetic procedures – unless you need them for a medical reason
- Dental services – available to NYC Care members and other uninsured patients through NYC H+H Options (a free or discount payment plan to make health care services affordable)
- Skilled nursing or long-term acute care
- Emergency care and hospital stays – Emergency Medicaid may cover these services

HOW TO GET AND MANAGE YOUR CARE

How to make your appointments

When you enrolled, the NYC Care Contact Center should have booked your first primary care visit. This appointment should be within two weeks of enrollment.

If you do not have your first primary care appointment yet, call the 24-hour NYC Care Contact Center at 1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273). There are no walk-in hours for routine visits, so you will need to make an appointment to see your provider. The NYC Care Contact Center can help if you need to make an appointment urgently.

IMPORTANT

If you need to change or cancel an appointment, please call the NYC Care Contact Center as soon as possible. This allows another patient to use the appointment time.

You can make all appointments with your primary care provider, Women's Health care provider or referred specialists by calling the NYC Care Contact Center or visiting MyChart (see next page).

When scheduling an appointment, please give:

- Your name
- The name of your primary care provider
- Your NYC Care membership number, located on the front of your membership card

Always bring your membership card to all NYC Care appointments.

About MyChart online

MyChart is a free, easy and secure tool to view and manage your health

information online any time. Access your medical record portal through the MyChart mobile app or website to:

- Ask for appointments with your primary care provider, Women's Health provider and referred specialists
- Get medication refills
- Review your lab results and visit notes
- Message your primary care provider and health care team
- Providers may also message you about your health care — saving you time and money because you do not have to come in person

To set up your MyChart account, there are two options:

1. Talk to a member of your health care team. You will then get an invite in your email to create an account.
2. Sign up on **mychart.nychealthandhospitals.org**

MyChart is a tool for your convenience, available in English, Spanish and French. You do not have to use MyChart to participate in NYC Care.

Get ready for your first appointment

To get the best care, your primary care provider needs to know your medical history and health goals.

Please bring the following to your first appointment:

- All of your prescription and over-the-counter medication (such as pills, injections, inhalers, herbs, supplements, etc.)
- Your filled-out Adult Initial Health History Form (you got this in the mail with your membership card)
- Your medical records (especially vaccination record, colonoscopy or mammogram reports and Pap smear results, etc.)
- Advance directive or health care proxy form
- Questions about your health or medication

BILLING AND FEES

NYC Care health services are available at a discount rate based on your household size and income. Find a list of fees for common services on the back of your NYC Care membership card or in the chart on the next page.

If your household income is greater than the limit for the household size in the chart, your bill will be based on the self-pay rate for the care received. Payment plans may be available.

How to pay

NYC Care encourages you to pay your fees at the time you get health care services. You can pay with cash, credit card or debit card. If you cannot pay then, NYC Care will mail the bill to your home.

If you get a bill you cannot pay, call the NYC Care Contact Center to discuss your options.

Important: When you enroll in NYC Care, discounts based on your household size and income may be applied to prior NYC Health + Hospitals bills.

POLICIES AND PROCEDURES

Patients' Bill of Rights

As a patient in a hospital in New York State, you have the right, consistent with law, to:

1. Understand and use these rights. If for any reason you do not understand or you need help, the hospital MUST provide assistance, including an interpreter.
2. Receive treatment without discrimination as to race, color, religion, sex, gender identity, national origin, disability, sexual orientation, age or source of payment.
3. Receive considerate and respectful care in a clean and safe environment free of unnecessary restraints.
4. Receive emergency care if you need it.
5. Be informed of the name and position of the doctor who will be in charge of your care in the hospital.
6. Know the names, positions and functions of any hospital staff involved in your care and refuse their treatment, examination or observation.
7. Identify a caregiver who will be included in your discharge planning and sharing of post-discharge care information or instruction.
8. Receive complete information about your diagnosis, treatment and

YOUR COST TO ACCESS CARE

Step 1

Find your household size (please include all adults and children who live with you).

Step 2

Find your household income (the amount that you get paid in a year) in one of the levels.

Step 3

Follow the column down to the bottom of the chart to see how much you can expect to pay based on your household size and income for clinic visits, emergency room visits, hospital stays and more.

Federal Poverty Levels	100% FPL	101 - 125% FPL		126 - 150% FPL		151 - 200% FPL		201 - 250% FPL		251 - 300% FPL		301 - 350% FPL		351 - 500% FPL	
Household Size	Less than	More than	Less than	More than	Less than	More than	Less than	More than	Less than	More than	Less than	More than	Less than	More than	Less than
1	$12,490	$12,491	$15,613	$15,614	$18,735	$18,736	$24,980	$24,981	$31,225	$31,226	$37,470	$37,471	$43,715	$43,716	$62,450
2	$16,910	$16,911	$21,138	$21,139	$25,365	$25,366	$33,820	$33,821	$42,275	$42,276	$50,730	$50,731	$59,185	$59,186	$84,550
3	$21,330	$21,331	$26,663	$26,664	$31,995	$31,996	$42,660	$42,661	$53,325	$53,326	$63,990	$63,991	$74,655	$74,656	$106,650
4	$25,750	$25,751	$32,188	$32,189	$38,625	$38,626	$51,500	$51,501	$64,375	$64,376	$77,250	$77,251	$90,125	$90,126	$128,750
5	$30,170	$30,171	$37,713	$37,714	$45,255	$45,256	$60,340	$60,341	$75,425	$75,426	$90,510	$90,511	$105,595	$105,596	$150,850
6	$34,590	$34,591	$43,238	$43,239	$51,885	$51,886	$69,180	$69,181	$86,475	$86,476	$103,770	$103,771	$121,065	$121,066	$172,950
7	$39,010	$39,011	$48,763	$48,764	$58,515	$58,516	$78,020	$78,021	$97,525	$97,526	$117,030	$117,031	$136,535	$136,536	$195,050

Clinic Visit for Adult	$0	$2	$3	$20	$30	$40	$50	$50
Clinic Visit for Child or Pregnant Woman	$0	$0	$0	$20	$30	$40	$50	$50
Behavioral Health Clinic Visit	$0	$0	$0	$15	$30	$40	$50	$50
Emergency Room Visit for Adult	$0	$3	$3	$75	$80	$100	$120	$120
Emergency Room Visit for Child or Pregnant Woman	$0	$0	$0	$75	$80	$100	$120	$120
Prescription Drugs (fee per prescription)	$2	$2	$2	$6	$10	$14	$18	$18
Ambulatory Surgery or MRI Testing	$0	$15	$25	$150	$300	$450	$550	$650
Inpatient Hospital Stay*	$0	$25	$25	$150	$400	$900	$1500	$1500
Co-pays and Deductibles	$0	$0	$0	$0	$10	$12	$18	$22

Fees for patients with household income that is more than the above will be charged based on the NYC Health + Hospitals Selfpay rate.
*Additional fees may be charged if savings are more than $8,000

prognosis.

9. Receive all the information that you need to give informed consent for any proposed procedure or treatment. This information shall include the possible risks and benefits of the procedure or treatment.
10. Receive all the information you need to give informed consent for an order not to resuscitate. You also have the right to designate an individual to give this consent for you if you are too ill to do so. If you would like additional information, please ask for a copy of the pamphlet "Deciding About Health Care — A Guide for Patients and Families."
11. Refuse treatment and be told what effect this may have on your health.
12. Refuse to take part in research. In deciding whether or not to participate, you have the right to a full explanation.
13. Privacy while in the hospital and confidentiality of all information and records regarding your care.
14. Participate in all decisions about your treatment and discharge from the hospital. The hospital must provide you with a written discharge plan and written description of how you can appeal your discharge.
15. Review your medical record without charge and obtain a copy of your medical record for which the hospital can charge a reasonable fee. You cannot be denied a copy solely because you cannot afford to pay.
16. Receive an itemized bill and explanation of all charges.
17. View a list of the hospital's standard charges for items and services and the health plans the hospital participates with.
18. Challenge an unexpected bill through the Independent Dispute Resolution process.
19. Complain without fear of reprisals about the care and services you are receiving and to have the hospital respond to you (and if you request it, a written response). If you are not satisfied with the hospital's response, you can complain to the New York State Health Department. The hospital must provide you with the State Health Department telephone number.
20. Authorize those family members and other adults who will be given priority to visit consistent with your ability to receive visitors.
21. Make known your wishes in regard to anatomical gifts. Persons 16 years of age or older may document their consent to donate their organs,

eyes and/or tissues, upon their death, by enrolling in the New York State Donate Life Registry or by documenting their authorization for organ and/or tissue donation in writing in a number of ways (such as a health care proxy, will, donor card or other signed paper). The health care proxy is available from the hospital.

Public Health Law (PHL) 2803 (1)(g) Patient's Rights, 10NYCRR, 405.7,405.7(a)(1), 405.7(c)

In addition, NYC Health + Hospitals is committed to compliance with the New York City Human Rights Law that states it is unlawful to discriminate on the basis of actual or perceived sex, including a person's "gender identity, self-image, appearance, behavior or expression," whether or not different from "that traditionally associated with the legal sex assigned to that person at birth."

Administrative Code of the City of New York Title 8

How to submit feedback to NYC Care

We want your visit to NYC Health + Hospitals facilities to be pleasant and safe. NYC Care welcomes the opportunity to address your concerns. Please call the NYC Care Contact Center or visit our website: **nychealthandhospitals.org/patient-guest-relations**

Confidentiality of information

All information about your care and treatment is kept confidential in accordance with the law. For more information about our Patient Confidentiality & Privacy notice, please visit our website at: **nychealthandhospitals.org/patient-privacy-notice**

ABOUT NYC HEALTH + HOSPITALS

- NYC Health + Hospitals is the largest public health care system in the United States. We provide essential in-patient, out-patient and home-based services to more than 1 million New Yorkers every year in more than 70 locations across the city's five boroughs.
- Our 11 acute care hospitals provide top-ranked trauma care, dozens of in-patient specialties and mental health services – making communities healthy through a robust network of hospital-based primary care services for children and adults. Our hospitals have earned numerous special designations for quality and culturally responsive care including LGBTQ Healthcare Equity Leader, Baby Friendly, Safe Sleep and top ranks by U.S. News and World Report.
- Our diverse workforce is uniquely focused on empowering New Yorkers, without exception, to live their healthiest life possible.

NYC HEALTH + HOSPITALS MISSION AND VALUES

NYC Health + Hospitals is committed to excellence in health care. Our providers work together to provide comprehensive, personalized care to all New Yorkers.

Mission

NYC Health + Hospitals' mission is to deliver high-quality health services with compassion, dignity and respect to all, without exception.

Vision

NYC Health + Hospitals' vision is to be a fully integrated health system that enables New Yorkers to live their healthiest lives.

Our Values

NYC Health + Hospitals has established the ICARE standards for all our staff. It will help us offer our patients a better experience when under our care and will increase staff awareness to become better engaged with the mission and vision of the organization.

Integrity. Keep Everyone Safe
Compassion. Keep Patients First
Accountability. Manage Resources
Respect. Work Together
Excellence. Pursue Excellence. Keep Learning

ZBULONI KUJDESIN SHËNDETËSOR NË QYTETIN E NJU-JORKUT

Manuali për anëtarët e **"NYC CARE"**

English page 1
Shqip faqe 17

NYC HEALTH+ HOSPITALS | NYC CARE

Miku ynë njujorkez:

Në qytetin tonë, ne e pranojmë që kujdesi shëndetësor është një e drejtë e njeriut. Tani, ne po i zbatojmë vlerat tona në praktikë. Falë "NYC Care" dhe profesionistëve të palodhur në "NYC Health + Hospitals", çdo njujorkezi – pavarësisht se ku ka lindur apo shumës së parave që disponon – i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor cilësor dhe të përballueshëm. Këtu përfshiheni edhe JU.

Me "NYC Care" do të keni mjekun tuaj të rregullt, i cili do të jetë i njohur për ju dhe do t'ju ofrojë kujdesin tuaj shëndetësor. Do të merrni llojet e shërbimeve që ju nevojiten, duke përfshirë kujdes obstetrik-gjinekologjik, kujdes pediatrik dhe kujdes për shëndetin mendor. Do të keni mundësinë të qëndroni të shëndetshëm dhe të kujdeseni në kohë dhe në mënyrë efikase për çdo problem shëndetësor. Dhe të gjitha shërbimet do të ofrohen me një çmim që mund ta përballoni.

Ky manual përshkruan tërësinë e përfitimeve dhe shërbimeve që merrni si anëtar i "NYC Care". Për më shumë informacion, telefononi 1-646-NYC-CARE në çdo kohë gjatë ditës ose natës, ose vizitoni faqen tonë të internetit në **nyccare.nyc**.

Mesazhi ynë është i thjeshtë: Merrni kartën tuaj të "NYC Care" dhe caktoni një takim me mjekun tuaj të ri. Mos prisni! Merrni kujdesin shëndetësor që ju nevojitet në kohën që ju nevojitet. Kjo është e drejta juaj si njujorkez!

Dr. Mitchell Katz
President dhe Drejtor Ekzekutiv
NYC Health + Hospitals

PËRMBAJTA

Rreth këtij manuali 20

Rreth "NYC Care" 20
Sa duhet paguar për të marrë pjesë 21
Si të rinovoni anëtarësimin 21

Karta juaj e anëtarësimit 21
Si të zëvendësoni kartën e anëtarësimit 22

Ofruesi juaj i kujdesit parësor 22
Si të zgjidhni ofruesin tuaj të kujdesit parësor 22

Shërbimet tuaja të kujdesit shëndetësor 23
Kujdesi parësor dhe parandalues 23
Kujdesi i specializuar 23
Shëndeti i sjelljes dhe përdorimi i substancave 23
Shëndeti i grave 24
Barnat 24
Vizioni 24
Shërbimet mbështetëse 24
Shërbimet e kujdesit shëndetësor që nuk mbulohen 25

Si të merrni dhe menaxhoni kujdesin 25
Si të caktoni takimet 25
Rreth MyChart online 26
Përgatitja për takimin tuaj të parë 26

Faturimi dhe tarifat 27
Mënyra e pagesës 27

Politikat dhe procedurat 27
Deklarata e të drejtave të pacientit 27
Kostoja juaj për marrjen e kujdesit 28
Mënyra e dërgimit të reagimeve për "NYC Care" 30
Konfidencialiteti i informacionit 30

Rreth "NYC Health + Hospitals" 31

Misioni dhe vlerat e "NYC Health + Hospitals" 32

RRETH KËTIJ MANUALI

Ky manual është udhëzuesi juaj për "NYC Care". Në të do të gjeni informacione të vyera rreth anëtarësimit tuaj dhe mënyrës së funksionimit të programit. Ju lutemi lexojeni atë përpara se të shkoni në takimin e parë me ofruesin tuaj të kujdesit parësor.

RRETH "NYC CARE"

"NYC Care" është çelësi në kujdesin shëndetësor të qytetit, i cili garanton shërbimet që ofrohen nga "NYC Health + Hospitals" për njujorkezët që nuk kualifikohen për sigurim shëndetësor ose që nuk e përballojnë dot sigurimin shëndetësor.

"NYC Care" ju ndihmon të qëndroni të shëndetshëm duke ofruar akses në kujdes të rregullt parandalues. Nëpërmjet këtij programi, ju ofrohet mundësia që të:

- Zgjidhni një ofrues të kujdesit parësor, i cili do të vihet në dijeni për anamnezën tuaj dhe synimet tuaja shëndetësore. Nuk keni pse të prisni derisa të sëmureni për të marrë kujdesin.
- Merrni një anëtarësim unik për të pasur akses në kujdesin shëndetësor. Në kartë tregohen tarifat që mund të parashikoni të paguani për shërbimet.
- Telefononi Qendrën e Kontaktit të "NYC Care", e disponueshme 24 orë në ditë/7 ditë në javë, kur ju duhet ndihmë. Në rast urgjence, telefononi gjithmonë 911.
- Siguroni akses 24 orë në ditë/7 ditë në javë në barna me recetë me kosto të ulët, duke përfshirë përsëritjen e rregullt të recetës jashtë orarit zyrtar të punës. Recetat mund t'i përsëritni gjithashtu brenda natës, kur ju nevojitet.

KU MUND TË PËRDORET "NYC CARE"?

"NYC Care" ofron një rrjet ofruesish kujdesi vetëm në ambientet e "NYC Health + Hospitals". Një listë të tarifave për marrjen e shërbimeve në këto qendra e gjeni në kartën tuaj.

Nëse merrni kujdes urgjent, shtroheni në spital apo vizitoni ofrues kujdesi jashtë rrjetit ose jashtë qytetit të Nju-Jorkut, mund t'ju faturohet një vlerë më e lartë.

Për një listë të vendndodhjeve të spitaleve "NYC Health + Hospitals" ku mund të përdorni "NYC Care", telefononi Qendrën e Kontaktit të "NYC Care" ose vizitoni **nyccare.nyc**

E rëndësishme: Personat që kualifikohen për "Medicaid", "Medicare", "Plan bazë, ose një Plan Shëndetësor të Kualifikuar (QHP) të ofruar sipas Aktit të Kujdesit të Përballueshëm (ACA), duhet të regjistrohen në planin e sigurimit që disponohet për ta.

Nëse keni aktualisht sigurim shëndetësor, MOS e hiqni atë. Sigurimi shëndetësor siguron më shumë zgjedhje dhe opsione për plotësimin e nevojave tuaja për kujdes shëndetësor.

Sa është kostoja e pjesëmarrjes

Duke qenë se "NYC Care" nuk është sigurim shëndetësor, nuk ka tarifa anëtarësimi, tarifa mujore apo prime. Kostoja që duhet të paguani për të marrë kujdes shëndetësor bazohet në një tarifë të ndryshueshme sipas shërbimit (shihni faqen 28).


Si të rinovoni anëtarësimin

"NYC Care" do të caktojë një këshillues financiar në "NYC Health + Hospitals" për të shqyrtuar situatën tuaj çdo 12 muaj. Shqyrtimi do të nxjerrë në pah nëse ju kualifikoheni për sigurim. Nëse nuk kualifikoheni, këshilltari financiar do t'ju ndihmojë të rinovoni anëtarësimin tuaj në "NYC Care".

KARTA JUAJ E ANËTARËSIMIT

Karta e anëtarësimit do t'ju dërgohet me postë. Mbajeni gjithmonë me vete këtë kartë, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

- Kur vizitoni ofruesin tuaj të kujdesit parësor
- Kur merrni ndonjë shërbim të kujdesit shëndetësor në ambientet e "NYC Health + Hospitals"



Karta e paraqitur është një model i anës së përparme dhe të pasme të një karte anëtarësimi në "NYC Care".

Karta juaj është unike dhe paraqet tarifat tuaja për shërbimet e kujdesit shëndetësor.

Si të zëvendësoni kartën e anëtarësimit

Nëse e humbisni kartën tuaj të anëtarësimit, telefoni Qendrën e Kontaktit të "NYC Care" në 1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273) për të porositur një kartë të re. Shërbimi ndaj klientit është i disponueshëm 24 orë në ditë/7 ditë në javë.



OFRUESI JUAJ I KUJDESIT PARËSOR

Ofruesi juaj i kujdesit parësor do të koordinojë kujdesin tuaj shëndetësor dhe do t'ju lidhë me shërbimet e tjera që ju nevojiten. Ofruesi juaj i kujdesit mund të jetë një mjek, një infermier praktikant ose një ndihmësmjek. Puna më e rëndësishme e tyre është që t'ju ndihmojnë të shmangni sëmundjet. Ky quhet kujdes parandalues (shembuj të tij janë vaksinimet dhe ekzaminimet shëndetësore rutinë). Marrja e rregullt e tij redukton gjasat që t'ju nevojitet kujdes urgjent.

Si të zgjidhni ofruesin tuaj të kujdesit parësor

Për kujdesin më të mirë parandalues, "NYC Care" ju nxit që të zgjidhni një ofrues të kujdesit parësor të cilit mund t'i besoni. Kjo do ta bëjë më lehtë ndarjen e informacioneve tuaja mjekësore dhe të informacioneve rreth mënyrës suaj të jetesës. Ju do të punoni bashkërisht për të nisur, ose për të vazhduar, një rutinë të shëndetshme që përfshin dietën, kontrollin e peshës dhe kryerjen e ushtrimeve fizike.

Qendra e Kontaktit e "NYC Care" ju ndihmoi të zgjidhnit ofruesin e kujdesit parësor kur u regjistruat. Nëse nuk keni zgjedhur apo dëshironi të ndryshoni ofruesin tuaj të kujdesit parësor, mund të telefononi Qendrën e Kontaktit të "NYC Care". Është e rëndësishme që të ndiheni komod me zgjedhjen tuaj.

SHËRBIMET TUAJA TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Si anëtar i "NYC Care", keni akses në shumë shërbime shëndetësore. Ofruesi juaj i kujdesit parësor do t'ju ndihmojë me koordinimin e tyre, duke përfshirë edhe të barnave. Për të gjitha shërbimet e specializuara (të tilla si kardiologjia ose podiatria) – nevojitet referim nga ofruesi juaj i kujdesit parësor – përveç shërbimeve shëndetësore për gratë.

Disa nga shërbimet e kujdesit shëndetësor që disponohen për ju janë:

Kujdesi parësor dhe parandalues

Ofruesi juaj i kujdesit parësor trajton shqetësimet fizike të zakonshme, siç janë tensioni i lartë i gjakut dhe dhimbjet. Ai mund të ofrojë vaksinimin rutinë dhe ekzaminime si mamografitë dhe kolonoskopitë. Ai kryen gjithashtu analiza për sëmundje kronike dhe ju ndihmon në menaxhimin e tyre.

Ofruesi i kujdesit parësor drejton ekipin tuaj të kujdesit shëndetësor. Ekipi mund të përfshijë infermierë, ndihmësmjekë, punonjës socialë, farmacistë, nutricionistë dhe asistentë. Të gjitha këta mund t'ju ndihmojnë të kërkoni referime ose të caktoni takime.

Në përgjithësi, nëse jeni të shëndetshëm, duhet ta vizitoni ofruesin e kujdesit parësor vetëm një herë në vit. (Pacientëve me sëmundje kronike u nevojiten vizita më të shpeshta.)

Gjithsesi, mund ta vizitoni ofruesin tuaj të kujdesit parësor në çdo moment që keni një problem shëndetësor. Për shërbime urgjente, Qendra e Kontaktit e "NYC Care" mund të caktojë takime brenda ditës 24 orë në ditë/7 ditë në javë.

Kujdesi i specializuar

Ofruesi juaj i kujdesit parësor punon ngushtë me specialistët dhe mund t'ju ndihmojë të vendosni nëse keni nevojë për shërbimet e tyre. Shembuj të shërbimeve të kujdesit të specializuar janë:

- Kardiologjia
- Rheumatologjia
- Ortopedia
- Podiatria
- Bariartrika
- Gastroenterologjia
- Kirurgjia e përgjithshme
- Kujdesi për veshin, hundën dhe fytin (ENT)
- Psikiatria

Shëndeti i sjelljes dhe përdorimi i substancave

Krahas shëndetit tuaj fizik, "NYC Care" është i vetëdijshëm se shëndeti mendor dhe i sjelljes është gjithashtu i rëndësishëm. Ofruesi juaj i kujdesit parësor është këtu për t'ju mbështetur në rast se po përjetoni një periudhë të gjatë trishtimi,

stresi, makthesh ose ankthi, apo nëse po përdorni duhan, alkool apo droga të tjera. Ofruesi juaj i kujdesit mund t'ju referojë te specialisti i duhur i shëndetit mendor dhe sjelljes, siç është punonjësi social, terapisti ose psikiatri.

Shëndeti i grave

Anëtarët e "NYC Care" marrin shërbime shëndetësore për gratë, të tilla si shërbimet obstetrike dhe gjinekologjike, planifikimi familjar, testimi për infeksione seksualisht të transmetueshme, etj.

E RËNDËSISHME

Nuk ju nevojitet referim nga një ofrues i kujdesit parësor për të caktuar një takim me një ofrues të kujdesit shëndetësor për gratë.

Barnat

Anëtarët e "NYC Care" marrin barna me recetë me kosto të ulët dhe akses 24 orë në ditë/7 ditë në javë në farmaci. Mos harroni të lexoni fletën informuese të barnave tuaja për të mësuar se kur dhe si duhet ta merrni ato.

Mund të përfitoni përsëritje të recetave për disa barna. Përsëritja e recetave mund të kërkohet në tri mënyra:

1. Shkoni në farmacinë pranë ambienteve të "NYC Health + Hospitals dhe kërkojuni që të telefonojnë ofruesin tuaj të kujdesit parësor.
2. Nëse keni një llogari "MyChart", identifikohuni në llogari dhe kërkoni përsëritjen e recetës.
3. Telefononi Qendrën e Kontaktit të "NYC Care" në 1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273).

Shikimi

Oftalmologët (okulistët) tanë mund t'ju ekzaminojnë sytë dhe t'ju japin recetë për mbajtjen e syzeve. Merrni referim nga ofruesi juaj i kujdesit parësor.

Shërbimet mbështetëse

Vendi dhe mënyra juaj e jetesës mund të ndikojnë në shëndetin tuaj fizik, mendor dhe të sjelljes. "NYC Care" është i vetëdijshëm për këtë, ndaj ofron shërbime mbështetëse. Punonjësit socialë pjesë e ekipit tuaj të kujdesit shëndetësor mund t'ju lidhin me ndihma strehimi, ligjore, financiare, ushqimore dhe nutricionale pa pagesë. Bisedoni me ofruesin e kujdesit parësor rreth mbështetjes sociale që ofron "NYC Care".

Shërbimet e kujdesit shëndetësor që nuk mbulohen

"NYC Care" nuk mbulon shërbimet e mëposhtme, por ju mund të jeni në gjendje t'i merrni te "NYC Health + Hospitals":

- Procedurat kozmetike - përvec rasteve kur ato ju nevojiten për arsye mjekësore
- Shërbimet dentare – të disponueshme për anëtarët e "NYC Care" dhe për pacientët e tjerë të pasiguruar përmes alternativave të "NYC H + H Options" (plan i marrjes falas ose me pagesë të reduktuar, në mënyrë që shërbimet e kujdesit shëndetësor të bëhen të përballueshme)
- Kujdesi i specializuar infermieror ose kujdesi akut afatgjatë
- Kujdesi urgjent dhe shtrimet në spital - Këto shërbime mund të mbulohen nga "Emergency Medicaid"

SI TË MERRNI DHE MENAXHONI KUJDESIN

Si të caktoni takimet

Qendra e Kontaktit e "NYC Care" duhet të ketë rezervuar vizitën tuaj të parë të kujdesit parësor në momentin kur u regjistruat. Ky takim duhet të jetë brenda dy javëve nga regjistrimi.

Nëse nuk e keni caktuar ende takimin tuaj të parë të kujdesit parësor, telefononi Qendrën 24-orëshe të Kontaktit të "NYC Care" në 1-646-NYC-CARE (1-646-692-2273). Nuk ka orare gjatë të cilave mund të paraqiteni pa planifikim për vizitat rutinë, ndaj duhet të caktoni një takim për të vizituar ofruesin tuaj të kujdesit. Qendra e Kontaktit e "NYC Care" mund t'ju ndihmojë nëse ju duhet të caktoni një takim urgjent.

E RËNDËSISHME

Nëse ju duhet të ndryshoni ose anuloni një takim, ju lutemi telefononi sa më shpejt Qendrën e Kontaktit të "NYC Care". Në këtë mënyrë mundësohet që koha e takimit të shfrytëzohet nga ndonjë pacient tjetër.

Të gjitha takimet me ofruesin e kujdesit parësor, ofruesin e kujdesit për gratë ose specialistët e referuar mund t'i caktoni duke telefonuar Qendrën e Kontaktit të "NYC Care" ose duke vizituar MyChart (referojuni faqes vijuese).

Kur planifikoni një takim, ju lutemi jepni:

- Emrin tuaj
- Emrin e ofruesit tuaj të kujdesit parësor
- Numrin e anëtarësimit tuaj në "NYC Care" që gjendet në anën e përparme të kartës së anëtarësimit

Merrni gjithmonë me vete kartën tuaj të anëtarësimit në të gjitha takimet me "NYC Care".

Rreth MyChart online

MyChart është një instrument pa pagesë, i lehtë dhe i sigurt për të parë dhe menaxhuar në çdo kohë informacionin tuaj shëndetësor online. Hyni në portalin e kartelës suaj mjekësore nëpërmjet aplikacionit celular MyChart ose faqes së internetit, për të:

- Kërkuar takime me ofruesin tuaj të kujdesit parësor, ofruesin e kujdesit shëndetësor për gratë dhe specialistët e referuar
- Përsëritur recetat e barnave
- Rishikuar rezultatet laboratorike dhe shënimet rreth vizitave
- Dërguar mesazh ofruesit të kujdesit parësor dhe ekipit tuaj të kujdesit shëndetësor
- Ofruesit e kujdesit mund t'ju dërgojnë gjithashtu mesazh rreth kujdesit tuaj shëndetësor - duke ju kursyer kohën dhe paratë, duke qenë se nuk ju duhet të paraqiteni personalisht

Ka dy mënyra për të regjistruar llogarinë tuaj në MyChart:

1. Bisedoni me një anëtar të ekipit tuaj të kujdesit shëndetësor. Më pas do të merrni një ftesë me email për të krijuar një llogari.
2. Regjistrohu në **mychart.nychealthandhospitals.org**

MyChart është një mjet ndihmës që disponohet në anglisht, spanjisht dhe frëngjisht. Nuk është nevoja të përdorni MyChart për të marrë pjesë në "NYC Care".

Përgatitja për takimin tuaj të parë

Për të marrë kujdesin më të mirë, ofruesi juaj i kujdesit parësor duhet të dijë anamnezën dhe synimet tuaja shëndetësore.

Ju lutemi merrni me vete dokumentet e mëposhtme në vizitën tuaj të parë:

- Të gjitha barnat tuaja me dhe pa recetë (si pilulat, injeksionet, inhalatorët, barnat popullore, suplementet, etj.)
- Formularin e plotësuar të anamnezës fillestare për të rriturit (formularin e keni marrë me postën me cilën morët kartën e anëtarësimit)
- Kartelën mjekësore (veçanërisht kartelën e vaksinimit, raportet e kolonoskopisë ose mamografisë dhe rezultatet e pap-testit etj.)
- Deklaratën paraprake të vullnetit ose formularin e prokurës së kujdesit shëndetësor
- Pyetjet rreth shëndetit ose barnat tuaja

FATURIMI DHE TARIFAT

Shërbimet shëndetësore të "NYC Care" ofrohen me tarifë të reduktuar në bazë të madhësisë së familjes dhe të ardhurave tuaja. Një listë e tarifave për shërbimet e zakonshme gjendet në anën e pasme të kartës suaj të anëtarësimit "NYC Care" ose në tabelën në faqen vijuese.

Nëse të ardhurat e familjes suaj e tejkalojnë limitin për madhësinë e familjes në tabelë, fatura juaj do të bazohet në tarifën e vetëpagesës për kujdesin e marrë. Mund të disponohen plane pagese.

Mënyra e pagesës

"NYC Care" ju nxit që t'i paguani tarifat në kohën e marrjes së shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Pagesën mund ta kryeni në formën e parave në dorë, me kartë krediti ose me kartë debiti. Nëse nuk jeni në gjendje të paguani, atëherë "NYC Care" do ta dërgojë faturën me postë në banesën tuaj.

Nëse merrni një faturë të cilën nuk mund ta paguani, telefononi Qendrën e Kontaktit të "NYC Care" për të diskutuar alternativat që keni.

E rëndësishme: Kur regjistroheni në "NYC Care" zbritjet e bazuara në madhësinë e familjes dhe të ardhurat mund të aplikohen përpara faturave "NYC Health + Hospitals".

POLITIKAT DHE PROCEDURAT

Deklarata e të drejtave të pacientit

Si pacient në një spital në shtetin e Nju-Jorkut, ju gëzoni të drejtat ligjore që:

1. T'i kuptoni dhe t'i shfrytëzoni këto të drejta. Nëse për ndonjë arsye nuk i kuptoni këto të drejta apo keni nevojë për ndihmë, spitali DUHET të sigurojë ndihmë, përfshirë një përkthyes.
2. Të merrni trajtim mjekësor pa u diskriminuar për shkak të racës, ngjyrës, fesë, seksit, identitetit gjinor, origjinës kombëtare, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, moshës apo burimit të pagesës.
3. Të merrni kujdes plot konsideratë dhe respekt në një ambient të pastër e të sigurt, pa kufizime të panevojshme.
4. Të merrni kujdes urgjent në rast se ju nevojitet.
5. Të informoheni për emrin dhe pozitën e mjekut që do të jetë përgjegjës për kujdesin tuaj në spital.
6. Të dini emrat, pozitat dhe funksionet e cilitdo prej punonjësve të spitalit të përfshirë në kujdesin tuaj dhe të mos e pranoni trajtimin, ekzaminimin ose vrojtimin prej tyre.

KOSTOJA JUAJ PËR MARRJEN E KUJDESIT

Hapi 1

Gjeni madhësinë e familjes suaj (ju lutemi përfshini të gjithë të rriturit dhe fëmijët që jetojnë me ju).

Hapi 2

Gjeni të ardhurat e familjes suaj (shumën që merrni gjatë një viti) në një nga nivelet.

Hapi 3

Ndiqni shtyllën deri në fund të tabelës për të parë se sa mund të parashikoni të paguani në bazë të madhësisë së familjes dhe të ardhurave tuaja për vizitat në klikë, vizitat në urgjencë, qëndrimet në spital etj.

Nivelet federale të varfërisë (FPL)	FPL 100%	FPL 101 - 125%		FPL 126 - 150%		FPL 151 - 200%		FPL 201 - 250%		FPL 251 - 300%		FPL 301 - 350%		FPL 351 - 500%	
Madhësia e familjes	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se	Më shumë se	Më pak se
1	$12,490	$12,491	$15,613	$15,614	$18,735	$18,736	$24,980	$24,981	$31,225	$31,226	$37,470	$37,471	$43,715	$43,716	$62,450
2	$16,910	$16,911	$21,138	$21,139	$25,365	$25,366	$33,820	$33,821	$42,275	$42,276	$50,730	$50,731	$59,185	$59,186	$84,550
3	$21,330	$21,331	$26,663	$26,664	$31,995	$31,996	$42,660	$42,661	$53,325	$53,326	$63,990	$63,991	$74,655	$74,656	$106,650
4	$25,750	$25,751	$32,188	$32,189	$38,625	$38,626	$51,500	$51,501	$64,375	$64,376	$77,250	$77,251	$90,125	$90,126	$128,750
5	$30,170	$30,171	$37,713	$37,714	$45,255	$45,256	$60,340	$60,341	$75,425	$75,426	$90,510	$90,511	$105,595	$105,596	$150,850
6	$34,590	$34,591	$43,238	$43,239	$51,885	$51,886	$69,180	$69,181	$86,475	$86,476	$103,770	$103,771	$121,065	$121,066	$172,950
7	$39,010	$39,011	$48,763	$48,764	$58,515	$58,516	$78,020	$78,021	$97,525	$97,526	$117,030	$117,031	$136,535	$136,536	$195,050

Vizitat në klinikë për të rriturit	$0	$2	$3	$20	$30	$40	$50	$50	
Vizita në klinikë për fëmijët ose gratë shtatzëna	$0	$0	$0	$20	$30	$40	$50	$50	
Vizita në klinikë për shëndetin e sjelljes	$0	$0	$0	$15	$30	$40	$50	$50	
Vizita në urgjencë për të rriturit	$0	$3	$3	$75	$80	$100	$120	$120	
Vizita në urgjencë për fëmijët ose gratë shtatzëna	$0	$0	$0	$75	$80	$100	$120	$120	
Medikamente me recetë (tarifa për recetë)	$2	$2	$2	$6	$10	$14	$18	$18	
Ekzaminimi MRI ose kirurgjia ambulatore	$0	$15	$25	$150	$300	$450	$550	$650	
Hospitalizimi*	$0	$25	$25	$150	$400	$900	$1500	$1500	
Bashkëpagesat dhe shumat e zbritshme	$0	$0	$0	$0	$10	$12	$18	$22	

Tarifat për pacientët me të ardhura familjare më të larta se vlerat e mësipërme do të faturohen mbi bazën e normës së Vetëpagesës të "NYC Health + Hospitals".
*Nëse kursimet tejkalojnë shumën $8000, mund të faturohen tarifa shtesë.

7. Të përcaktoni një kujdestar që do të përfshihet në planifikimin e daljes suaj nga spitali dhe në dhënien e informacionit ose udhëzimeve për kujdesin tuaj pas daljes nga spitali.
8. Të merrni informacion të plotë rreth diagnozës, trajtimit dhe prognozës suaj.
9. Të merrni të gjithë informacionin që ju nevojitet për të dhënë pëlqimin e informuar për ndonjë procedurë ose trajtim të propozuar. Ky informacion do të përfshijë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e mundshme të procedurës ose trajtimit.
10. Të merrni të gjithë informacionin që ju nevojitet për të dhënë pëlqimin e informuar për ndonjë urdhër që të mos riktheheni në jetë. Ju gjithashtu gëzoni të drejtën që të caktoni një individ për ta dhënë këtë pëlqim për ju, në rast se jeni tepër i sëmurë për ta dhënë vetë. Nëse dëshironi informacion shtesë, ju lutemi kërkoni një kopje të broshurës "Marrja e vendimeve rreth kujdesit shëndetësor – Një udhëzues për pacientët dhe familjet".
11. Të mos e pranoni trajtimin dhe të viheni në dijeni për efektin që mund të ketë ky mospranim në shëndetin tuaj.
12. Të mos pranoni të merrni pjesë në një studim kërkimor. Ndërkohë që merrni vendimin për të marrë pjesë ose jo, ju keni të drejtën për një shpjegim tërësor.
13. T'ju sigurohet ruajtja e privatësisë gjatë kohës që jeni në spital dhe konfidencialitetit të të gjithë informacionit dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me kujdesin tuaj.
14. Të merrni pjesë në të gjitha vendimet rreth trajtimit tuaj dhe daljes nga spitali. Spitali duhet t'ju japë një plan me shkrim të daljes nga spitali dhe një përshkrim me shkrim të mënyrës se si mund ta apeloni daljen tuaj nga spitali.
15. Të rishqyrtoni kartelën tuaj mjekësore pa pagesë dhe të merrni një kopje të saj, për të cilën spitali mund të kërkojë një pagesë të arsyeshme. Nuk mund t'ju mohohet dhënia e një kopjeje vetëm ngaqë nuk keni mjete financiare për të paguar.
16. Të merrni një faturë dhe një shpjegim të detajuar për të gjitha pagesat.
17. T'ju paraqitet një listë e pagesave standarde të spitalit për artikujt dhe shërbimet, si dhe të planeve shëndetësore në të cilat merr pjesë spitali.
18. Të kundërshtoni një faturë të paparashikuar nëpërmjet procesit të Zgjidhjes së Pavarur të Mosmarrëveshjeve.
19. Të ankoheni pa frikën e masave ndëshkuese në lidhje me kujdesin dhe shërbimet që po merrni dhe të merrni një përgjigje nga spitali (dhe të merrni një përgjigje me shkrim, nëse e kërkoni). Nëse nuk jeni të kënaqur

me përgjigjen e spitalit, mund të ankoheni pranë Departamentit të Shëndetit të Shtetit të Nju-Jorkut. Spitali duhet t'ju japë numrin e telefonit të Departamentit të Shëndetit të Shtetit.

20. Të autorizoni ata anëtarë të familjes dhe të rritur të tjerë të cilëve do t'u jepet përparësi për t'ju vizituar në përputhje me gjendjen tuaj për të pritur vizitorë.

21. Të shprehni dëshirat tuaja lidhur me dhurimet e organeve. Personat e moshës 16 vjeç e sipër mund ta dokumentojnë pëlqimin e tyre për të dhuruar organet, sytë dhe/ose indet e tyre pas vdekjes duke u regjistruar në programin "Dhuro jetë" të Departamentit të Shëndetit të shtetit të Nju-Jorkut ose duke dhënë autorizimin e tyre për të dhuruar organet dhe/ose indet me shkrim në një sërë mënyrash (si p.sh. me anë të një prokure për kujdesin shëndetësor, deklarate të shprehjes së vullnetit, karte dhuruesi ose ndonjë dokumenti tjetër të nënshkruar). Prokura e kujdesit shëndetësor vihet në dispozicion nga spitali.

Ligji për shëndetin publik (PHL) 2803 (1)(g) Të drejtat e pacientit, 10NYCRR, 405.7,405.7(a)(1), 405.7(c)

Gjithashtu, "NYC Health + Hospitals" është angazhuar që të veprojë në përputhje me Ligjin për të drejtat e njeriut të qytetit të Nju-Jorkut që parashikon se diskriminimi mbi bazën e seksit real dhe të perceptuar, duke përfshirë "identitetin gjinor, imazhin e vetvetes, pamjen, sjelljen ose shprehjen e personit," pavarësisht nëse ndryshon ose jo nga "seksi tradicionalisht i lidhur me seksin e përcaktuar në dokumentet zyrtare në momentin e lindjes së personit".

Kodi administrativ i qytetit të Nju-Jorkut, titulli 8

Mënyra e dërgimit të reagimeve për "NYC Care"

Ne dëshirojmë që vizita juaj në ambientet e "NYC Health + Hospitals" të jetë e këndshme dhe e sigurt. "NYC Care" e mirëpret mundësinë për të trajtuar shqetësimet tuaja. Ju lutemi telefononi Qendrën e Kontaktit të "NYC Care" ose vizitoni faqen tonë të internetit:
nychealthandhospitals.org/patient-guest-relations

Konfidencialiteti i informacionit

I gjithë informacioni që ka të bëjë me kujdesin dhe trajtimin tuaj mbahet konfidencial në përputhje me ligjin. Për më shumë informacion rreth njoftimit tonë "Konfidencialiteti dhe privatësia e pacientit", ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit në: **nychealthandhospitals.org/patient-privacy-notice**

RRETH "NYC HEALTH + HOSPITALS"

- "NYC Health + Hospitals" është sistemi më i madh i kujdesit shëndetësor publik në Shtetet e Bashkuara. Ne ofrojmë shërbime thelbësore spitalore, ambulatore dhe në banesë për më shumë se 1 milion njujorkezë çdo vit, në më shumë se 70 qendra të shpërndara në të pesta lagjet e qytetit.
- 11 spitalet tona të kujdesit akut ofrojnë kujdes të nivelit të lartë për traumat, dhjetëra shërbime të specializuara për pacientët e hospitalizuar dhe shërbime të shëndetit mendor – duke krijuar komunitete të shëndetshme nëpërmjet një rrjeti të konsoliduar shërbimesh të kujdesit parësor me bazë në spital për fëmijët dhe të rriturit. Spitalet tona kanë fituar emërtime të shumta të veçanta për kujdesin cilësor dhe të përgjegjshëm nga pikëpamja kulturore, ndër të cilat "LGBTQ Healthcare Equity Leader (Lider për barazinë në kujdesin shëndetësor për personat lesbike, gei, biseksualë, transgjinorë dhe queer/të pavendosur (LGBTQ)", "Baby Friendly (Miqësor me fëmijët)", "Safe Sleep (Gjumë i qetë)" dhe renditje si më të mirat nga "U.S. News and World Report".
- Fuqia jonë punëtore është e fokusuar në mënyrë unike në krijimin e mundësisë që njujorkezët të jetojnë jetën më të shëndetshme të mundshme.

MISIONI DHE VLERAT E "NYC HEALTH + HOSPITALS"

"NYC Health + Hospitals" është e përkushtuar ndaj kujdesit shëndetësor të përsosur. Ofruesit tanë të kujdesit punojnë së bashku për të ofruar kujdes gjithëpërfshirës të personalizuar për të gjithë njujorkezët.

Misioni

Misioni i "NYC Health + Hospitals" është të ofrojë shërbime shëndetësore cilësore me dhembshuri, dinjitet dhe respekt, pa përjashtim.

Vizioni

Vizioni i "NYC Health + Hospitals" është të jetë një sistem i integruar plotësisht që u mundëson nju-jorkezëve të jetojnë jetën më të shëndetshme të mundshme.

Vlerat tona

"NYC Health + Hospitals" ka vendosur standardet ICARE për të gjithë stafin tonë. Ato do të na ndihmojnë t'u ofrojmë pacientëve tanë një përvojë më të mirë ndërsa marrin kujdesin tonë dhe të rrisin ndërgjegjësimin e stafit për t'u angazhuar më mirë me misionin dhe vizionin e organizatës.

Integriteti. Ruajta e sigurisë së kujtdo
Dhembshuria. Mbajtja e pacientëve në fokus
Përgjegjshmëria. Menaxhimi i burimeve
Respekti. Puna e përbashkët
Përsosmëria. Përpjekja për të arritur përsosmëri. Mësimi i vazhdueshëm